

Thirrja është e hapur nga data 01.03.2024 deri më 11.03.2024

## TERMAT E REFERENCËS

**Mentor/e për angazhim në kuadër të projektit “Fuqizimi i komuniteteve të cenushme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës”**

<b>Organizata</b>	<b>OJQ “NEVO KONCEPTI</b>
<b>Objektivi përgjithshëm</b>	<b>Fuqizimi i vajzave dhe djemve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunat e synuara me njohuri, kapacitet, aftësi dhe mundësi për të kaluar në moshë madhore dhe punë dinjetoze dhe të qëndrueshme.</b>

### 1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizim dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumtave dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

OJQ Nevo Koncepti nga muaji tetor të viti 2023 ka filluar të zbatojë projektin “Fuqizimi i komuniteteve të cenushme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës në partneritet me Save the Children në Kosovë, financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim. Projekti po zbatohet në Komunën e Prizrenit, Gjakovës dhe Fushë Kosovës.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

### 2. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

“Fuqizimi i komuniteteve të cenushme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës” është projekt tre vjeçarë i cili implementohet nga OJQ “Nevo Koncepti” në partneritet me Save the Children në Kosovë, financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim dhe ka si qëllim kryesor fuqizimin e vajzave dhe djemve nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë duke u ofruar atyre njohuritë, aftësitë dhe mundësitë e nevojshme për një tranzicion të suksesshëm në moshën madhore dhe punë dinjetoze dhe të qëndrueshme.

### 3. OBJEKTIVA

OJQ “Nevo Koncepti” po synon të angazhojë tre (3) mentor/e lokal/e me bazë në Prizren, Gjakovë dhe Fushë Kosovë për një periudhë 20 mujore për të mbështetur dhe mentoruar të rinjtë nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë. Mentori/ja lokal/e do t'i nënshtrohet trajnimit intensiv në qasjen e Aftësive për Jetë të Save the Children dhe më pas do të punojë me të rinjtë në grupe të vogla ose individualisht për të ofruar mentorim, mbështetje dhe inkurajim, ndërsa monitoron progresin e tyre dhe adreson çdo sfidë që ata hasin.

### 4. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Punon ngushtë me menaxherin e projektit për të zbatuar dhe zhvilluar aktivitetet e parapara në bazë të nevojave të identifikuara dhe planifikimit në bashkëpunim me Nevo Konceptin.
- Merr pjesë aktive dhe angazhohet në sesionet trajnuese mbi qasjen e aftësive për jetë (LS4S) dhe aplikimin e saj në sesione të mentorimit të nxënësve të shkollave partnere profesionale.
- Zhvillon sesione mentorimi me grupe të vogla apo në mënyrë individuale me nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shkollat partnere profesionale.
- Bashkëpunon me mentorët të tjerë të komunave të tjera në të cilat implementohet projekti.
- Punon në bazë të politikave të NVK-s me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve/nxënësve. Siguron materiale mësimore për përfituesit dhe ndihmon në organizimin e aktiviteteve për zhvillim personal dhe orjentim në karrierë të përfituesve.
- Prezenton dhe promovon projektin tek palët e interesit si dhe bashkëpunon ngushtë me institucione si shkollat partnere, zyret komunale për komunitete dhe kthim, drejtoritë komunale të arsimit etj.
- Bashkëpunon dhe shkëmben informacione të përditësuara me Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit në Arsimin e Obliguar.
- Vijnë takime rregullta të Ekipeve për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit në Arsimin e Obliguar, së bashku me Nevo Konceptin.
- Ndihmon menaxherin e projektit në zhvillimin e fushatës për regjistrim të përfituesve, identifikon dhe ndërmjetëson në procesin e regjistrimit.
- Përgatit raport narativ dhe statistikor për periudhën e angazhimit me Nevo Koncepti.
- Mban komunikim efektiv me stafin e projektit, akterët të tjerë dhe palët e interesuara duke raportuar rregullisht nga mentorimi dhe monitorimi duke njoftuar për arritjet, sfidat dhe vështësitë e identifikuara.

### 5. POLITIKA E MBROJTJES SË FËMIJËVE

Si kusht për lidhjen e një marrëveshjeje, mentori/ja i/e përzgjedhur duhet të nënshkruajë Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve të OJQ “Nevo Koncepti” dhe të angazhohet për t'iu përmbajtur termave dhe kushteve të saj.

## 6. AFATI KOHOR

Angazhimi i mentorëve do të jetë njëzet(20) muaj për gjatë jetë gjatësisë së projektit.  
Mentorët nuk angazhohen përgjatë periudhës së pushimeve verore të procesit arsimor.

## 7. PROCEDURA E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet ti dërgojnë këto dokumente:

1. Curriculum Vitae (CV);
2. Vërtetim nga ana Universitetit/Kolegjit I/e cili/a është ndjekës aktiv i studimeve( Aplikuesit me Diplom Bachelor kanë përparësi).
3. Letër Motivuese.
4. Dëshmi e ndonjë pune/përvoje të mëhershme

Aplikimi duhet të dërgohet jo më largë se data 11.03.2024 në [m.elshani@nevokoncepti.org](mailto:m.elshani@nevokoncepti.org) duke kopjuar në (cc) [o.osmani@nevokoncepti.org](mailto:o.osmani@nevokoncepti.org)